



Plazmë Gjak
Pllakëza
Pllakëza Pllakëza
Gjak
Pllakëza

Përse dhuroni?

Gjak Pllakëza
Gjak Pllakëza
Pllakëza Gjak
Pllakëza Pllakëza
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Plazmë
Gjak
Pllakëza Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Plazmë
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Gjak i kordonit të kërthizës
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Gjak
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Gjak
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Gjak
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Gjak
Pllakëza Pllakëza Pllakëza
Pllakëza Pllakëza Pllakëza

Dhurimi i gjakut, një gjest i domosdoshëm

Duke dhuruar gjakun tuaj mund të ndihmoni shumë persona, për shembull një grua që ka humbur shumë gjak gjatë lindjes, të marrë forcat, ose të përmirësohet gjendja shëndetësore e një personi që vuan nga një tumor dhe kemioterapia e ka dobësuar, ose të ndihmoni shërimin e personave që vuajnë nga sëmundjet e gjakut.

Jepni kontributin tuaj për prodhimin e Imunoglobulinave dhe mjekimeve të tjera, të cilat ndihmojnë imunitetin e organizmit dhe janë produkte që realizohen nëpërmjet plazmës.

Deri më sot nuk egziston asnjë produkt në gjendje të zëvendësoje gjakun e prodhuar nga organizmi i njeriut. Gjaku nuk mund të prodhohet artificialisht. Kjo "pasuri" e pazëvendësueshme është e domosdoshme në terapinë e shumë sëmundjeve dhe varet nga zemërgjerësia e ndjenja e qytetërimit të dhuruesve.

Dhurimi i gjakut vullnetarisht dhe në mënyrë të ndërgjegjshme, bën të mundur jo vetëm ndihmën ndaj të tjerëve, por edhe për vetveten, sepse duke vepruar kështu pasurohet një e mirë e përbashkët, prej së cilës, secili prej nesh mund të përfitojë në moment nevojë.

Gjaku dhe përbërësit e tij

Gjaku është një ind i lëngshëm, që qarkullon në enët e gjakut, llogaritet të përbëjë rreth 8% të peshës së trupit të njeriut dhe përbëhet nga një pjesë e lëngshme, plazma, dhe nga një pjesë e dendur e përfaqësuar nga rruazat e kuqe, plazma dhe piastrina (pllakëza).

Dhurimi i gjakut është një veprim fisnik, që lejon kurimin e 1 milion të sëmurëve në vit.

Cilat janë format e ndryshme të dhurimit?

Dhënia e gjakut është forma e dhurimit që haset më shpesh. Lejon që të merren njëkohësisht të gjithë komponentet e gjakut: rruazat e bardha/kuqe piastrine (pllakëzat) të cilat ndahen më pas.

Dhënia në aferezë lejon marrjen e një komponenti të vetëm të gjakut, nëpërmjet një ndarësi të qelizave, të gjithë komponentët e tjerë i kthehen dhuruesit. Është e mundur të merren 2 komponentë njëkohësisht, në këtë rast flitet për dhënie multikomponente.

Dhënia në aferezë ofron mundësinë të merren në sasi të mëdha komponentët, për të cilët të sëmurët kanë nevojë. Dhënia në aferezë zgjat më shumë kohë sesa dhënia e gjakut normal (të tërë).

Ky tip dhurimi, në përgjithësi, i propozohet dhuruesve që kanë eksperiencë në dhënie e gjakut. Dhuruesit kanë mundësi të alternojnë dhënie e gjakut komplet me dhënie në aferezë.

Intervali kohor midis dy dhurimeve

Mund të jap	Nëse kam dhënë	Gjak komplet	Plasmaferesi	Multikomponent: rruaza të kuqe + plazma pjastrina	Multikomponent: plazma + pjastrina
Gjak komplet		90 ditë	14 ditë	90 ditë	14 ditë
Plasmaferesi		30 ditë	14 ditë	30 ditë	14 ditë
Multikomponent: rruaza të kuqe + plazma pjastrina		90 ditë	14 ditë	90 ditë	14 ditë
Multikomponent: plazma + pjastrina		30 ditë	14 ditë	30 ditë	14 ditë

Si funksionon dhurimi i gjakut?

Dhënia, ciladoqoftë (e gjakut apo e komponentëve) zhvillohet në 4 faza:

Regjistrimi

Ekipi mjekësor merr të dhënat tuaja ,duke i regjistruar në Database(lista e dhuruesve) e Sistemit Transfuzional ,verifikon identitetin tuaj nëpërmjet një dokumenti identifikimi dhe ju fton t'ju përgjigjeni një pyetësori, që ju plotësoni me përgjigjet tuaja, me qëllim që të pregatitet biseda e paradhurimit.

Vizita e pranueshmërisë

Para çdo dhurimi do t'ju merren disa kampione gjaku për testimin e paradhurimit, ju do të gjeni një mjek i cili do t'ju bëjë një intervistë konfidenciale dhe një vizitë mjekësore me qëllim që të verifikojë përshtatshmerinë tuaj ndaj dhurimit si respekt,siguri dhe garanci si të dhuruesit të gjakut ashtu edhe të pacientit / marrës.

Marrja e gjakut

Marrja (e gjakut) ose e komponenteve te tij kryhet nga personeli shëndetësor i pregatitur dhe i kualifikuar.Proçedura për marrjen e gjakut është e lehtë dhe e parrezikshme, pajisjet që përdoren janë të dizinfektuara dhe sterile,prandaj është e kuptueshme parrezikshmëria për dhuruesin.

Koha e pushimit dhe e marrjes së forcave

Pas dhurimit, do t'ju ofrohet mëngjesi, përfitoni nga ky moment për të pushuar e për të marrë veten.



Ku përfundon gjaku që ju dhuroni?

Cilidoqftë vendi ku kryeni dhurimin tuaj, pas marrjes së gjakut pason një procedurë e njëjtë kontrollësh që e dërgon me siguri të plotë nga dhuruesi tek pacienti/marrës.



1 - Përpunimi i komponentëve të gjakut

Gjaku i marrë ndahet nëpërmjet një centrifuge, për të marrë komponentët e ndryshëm (rruazat e kuqe, piastrina (plakëza)). Pacienti merr vetëm komponentin e gjakut për të cilin ka nevojë.



2 - Cilësimi biologjik i gjakut

Në çdo dhurim gjaku merren disa kampionë për t'u analizuar; vetëm në rast se kërkimi i elementeve infektues që kompromentojnë dhurimin (hepatiti B dhe C, HIV, sifilizi) ka rezultat negativ, sasi të e gjakut konsiderohen të vlefshme dhe përdoren për pacientët.



3 - Shpërndarja

Komponentët e gjakut, të ndarë, kontrolluar dhe të konsideruar të vlefshëm, i ndahen reparteve të spitaleve që kanë bërë kërkesë për gjak apo komponentët e tij, pasi janë kryer testet e pajtueshmërisë dhurues (gjaku)-pacient/marrës.

Cilidoqftë vendi ku mbledhet gjaku, pas marrjes (së gjakut), kryhet një procedurë e njëjtë kontrolli, si ajo e përshkruar më lart, që e transferon në mënyrë të sigurt nga dhuruesi tek pacienti/marrës

Fjalë kyçe: SIGURIA

Çdo qese e gjakut të marrë dhe kampionët përkatës, janë të regjistruar dhe të identifikuar me një kod unik, për të siguruar nga një ekstrem në tjetrin (të procesit transfuzional), një përndjekje të përsosur (për 30 vjet), të garantuar me siguri, të rrugëve të përndjekura nga gjaku i dhuruar.

Cilat janë kushtet për dhurimin e gjakut?



Në disa raste duhet të prisni për të dhuruar gjakun tuaj. Kur?

- Të paktën 7 ditë pas mbarimit të një kure me antibiotikë
- 7 ditë pas kurave të dhëmbëve tek dentisti (për mbushjet janë të mjaftueshme 48 orë)
- Të paktën 14 ditë pas një infeksioni
- 3 muaj pas një udhëtimi në zona me rrezik endemik (tipikë të zonës) për sëmundje tropikale
- 6 muaj pas një udhëtimi në një vend ku është e pranishme malarja
- 4 muaj pas një çfarëdolloj situatë të rrezikshme nga pikëpamja e transmetimit të sëmundjeve infektive: një ndërhyrje kirurgjikale, një hetim endoskopik (gastroskopi, kolonskopi, artroskopi etj...) një tatuazh, piercing, shpuarje veshësh etj...



Ju mund ta dhuroni gjakun tuaj nëse:

- Jeni në një moshë nga 18 deri në 65 vjeç
- Një mjek ju deklaron (pas një vizite) të përshtatshëm për dhurimin
- Peshoni të paktën 50 kg
- Sasia e Hemoglobinës në gjakun tuaj, është e mjaftueshme
- Jeni i pajisur me një dokument identifikimi

Për të gjitha pyetjet që mund t'ju lindin, mos hezitoni të kontaktoni mjekët e strukturës transfuzionale më të afërt!

Listën e strukturave ju mund ta gjeni në internet, në adresën: www.regione.toscana.it/donareilsangue në seksionin: Centro Regionale Sangue.

Çfarë etike për dhurimin e gjakut?

Anonimati: Identiteti i dhuruesve dhe i pacientit/marrës trajtohen sipas ligjeve të privacy nga operatorët e Sistemit Transfuzional Toskan (Sistema Trasfusione Toscana).

I vullnetshëm: Dhurimi i gjakut është një veprim i kryer lirisht, pa asnjë detyrim.

No profit-Jo fitimprurës: Gjaku dhe komponentet e tij nuk mund të jenë burime fitimi; çmimi i një njësie gjaku ose e një komponenti të tij është i bazuar në shpenzimet për mbledhjen, pregatitjen, cilësimin dhe shpërndarjen.

Higjena: Për çdo dhurues gjaku, pajisjet e përdorura për marrjen (e gjakut) janë sterile dhe përdoren vetëm një herë.

Periodiciteti: Dhurimi i herëpashershëm përbën një garanci besueshmërie dhe sigurie për pacientin /marrës por edhe për sigurinë e furnizimit. Dhuruesi është i kontrolluar rregullisht nga pikëpamja shëndetësore, si pasojë e kontrolleve të mjekut dhe analizave të gjakut. Ndër të tjera, vendimi i tij për të dhuruar nuk është i kushtëzuar nga faktorë të tjerë si ata emocionalë.

Falas: Dhënia e gjakut bëhet falas, nuk mund të paguhet në asnjë mënyrë, mungesa e faktorit ekonomik është element themelor i sigurisë transfuzionale. Përdorimi i gjakut me pagesë, përveçse për probleme morale, duhet të refuzohet sepse rrit rrezikun e transfuzionit. Në Itali është i jashtëligjshëm (në bazë të artikullit 22, të ligjit 219/2005).

Siguria: Mospagimi, vizita e paradhurimit dhe testimet e diagnozat e kryera, garantojnë sigurinë e produkteve transfuzionale si për pacientët/marrës, ashtu edhe për shëndetin e dhuruesve.

Cilësia: Respektimi i këtyre rregullave dhe kontrollet e shumta ndaj materialeve të përdorura, garantojnë një cilësi të lartë të produkteve transfuzionale.

Dhurimi i gjakut të tërë (komplet)

Për çfarë shërben gjaku?

Rruazat e kuqe të gjakut (leukocitet), përdoren kryesisht për të kuruar aneminë e pacientëve me sëmundje të gjakut ose nga tumoret. Kemioterapia, në fakt, shkatërron qelizat e palcës së kurrizit (rruazat e kuqe, piastrina/ pllakëza) që kanë nevojë të transfuzohen. Rruazat e kuqe i jepen edhe pacientëve që kanë pasur hemoragji të rënda, që ndodhin si pasojë traumash, ndërhyrjesh kirurgjikale (psh. transplantime/trapiante) ose gjatë lindjeve.

Sa i nevojshem është gjaku?

Gjaku dhe komponentet e tij janë gjithmonë e më të kërkuar për shkak të mplakjes së popullsisë, novacionit dhe përmirësimit të kurave.

Periudhat e mangësisë janë të shpeshta gjatë gjithë vitit, sidomos në verë. Gjaku nuk nevojitet gjithmonë dhe vetëm për situata urgjente. Për të plotësuar nevojat është e domosdoshme rritja e dhurimeve dhe e dhuruesve.

Kush mund të dhurojë?

Të gjithë personat e konsideruar të përshatshëm nga mjekët e shërbimit transfuzional.



Federiko
34 vjeç

Pas 10 vjet sëmundje, sot jam një person i lumtur, jam bërë baba i Rebekës, kam fituar medaljen e artë dhe jam e rekordmen botëror në not, 50 metra stil bretkosë në Lojrat e XV Botërore 2005 për personat që kanë bërë një transplantim. Transplantimi im u bë i mundur falë bujarisë së dikujt që më dhuroi një organ dhe shumë të tjerëve që më dhuruan gjakun e tyre.

Ju duhet të dini...



Sasia: Sasia e gjakut që ju merret mesatarisht në çdo dhurim është e vendosur me Dekret ministerial në 450 centimetra /kub+/- 10%.



Kohëzgjatja: Marrja e gjakut, në vetvete, zgjat vetëm 10 minuta, nga mbërritja në daljen tuaj kalojnë zakonisht rreth 45 minuta.



Ruajtja: Rruazat e kuqe: rruazat e kuqe ruhen për 42 ditë.



Intervali i dhurimit: Është e nevojshme të prisni 90 ditë midis dy dhurimeve. Numri i dhurimeve nuk duhet të kapërcejë 4 në një vit për burrat dhe 2 në vit për gratë në moshë fertile (mosha kur një grua mund të ngelet shtatzëne dhe të ketë fëmijë).

Dhurimi i plazmës

Për çfarë shërben plazma?

Me dhurimin e plazmës ju ndihmoni shumë pacientë. Plazma mund të përdoret në 2 forma.

1. Plazma për përdorim klinik (mjekësor)
2. Në formën e produkteve farmaceutike pas një trajtimi në mënyrë industriale

Nga plazma përfitojnë sidomos personat me ustione (djegje) të mëdha, personat që vuajnë nga sëmundjet e gjakut, pacientë me probleme koagulimi të gjakut ose probleme imuniteti të organizmit, sëmundje neurologjike ose të mëlcisë.

Cilat janë nevojat?

Nevojat për plazmë janë (sidomos për t'u dërguar në trajtim industrial) gjithmonë e më në rritje, sidomos për shkak të kërkesave (recetave) për immunoglobulinë (në sasi pak më të vogël edhe albuminë) që janë nënprodukte të plazmës. Paralelisht rriten nevojat e plazmës për përdorim klinik: çdo ditë, vetëm në Toskanë, janë të nevojshme më shumë se 25.000 njësi terapeutike.



Louis Omar
24 vjeç

Unë kam lindur në Peru dhe kam ardhur në Itali në moshën 6 vjeç për t'u kuruar nga hemofilia. Këtu gjeta kura të përshtatshme falë hemoderivateve (nënprodukte të gjakut) të prodhuara me plazmë të dhuruar. Mundem, në këtë mënyrë, të bëj një jetë normale dhe tani studioj në Universitet për t'u bërë Teknik për parandalimin.

Ju duhet të dini...



Sasia: mund t'ju merren deri në 650 ml plazmë për çdo dhurim.



Kohëzgjatja: marrja e plazmës në vetvete zgjat nga 35-45 minuta, nga mbërritja në daljen tuaj kalon zakonisht 60 minuta.



Ruajtja: plazma e mbledhur, ngrihet menjëherë dhe kështu mund të ruhet deri në 24 muaj.



Intervali i dhurimit të plazmës: Është e nevojshme të priten 14 ditë midis dy dhurimeve. Zakonisht fiksohet një takim për dhurimin.

Si transformohet plazma?

1



Shërbimi shëndetësor kombëtar (Servizio Sanitario Nazionale) organizon marrjen, përpunimin, cilësimin biologjik dhe shpërndarjen e plazmës.

2



Industria e konvencionaluar fraksionon (ndan) plazmën për prodhimin e mjekimeve që rrjedhin nga plazma: albumina, immunoglobulina, elemente të koagulimit, antitrombina III, të cilat iu shpërndahen më pas spitaleve.

2

Plazma për përdorim klinik (mjekësor) ju jepet pacientëve pa transformimin industrial.



3


Pacienti mund ta marrë plazmën edhe në formë produktesh farmaceutike që rrjedhin nga përpunimi industrial i plazmës.

Kush mund të dhurojë plazmë?

Të gjithë dhuruesit mund të japin plazmë.

Megjithatë dhuruesit me grup gjaku AB dhe B janë kandidatët e preferuar për këtë lloj dhurimi

Dhurimi i piastrinave (pllakëzave të gjakut ose trombociteve)



Fulvia 30 vjeç

Pas një sëmundje infektive, palca e kurrizit tim filloi të funksiononte çdo ditë më pak derisa arriti në aplasia: për këtë arsye kam nevojë për transfuzione të shpeshta me piastrina (pllakëza).

Gjendja u zgjidh nga një transplantim, trajtim që pati nevojë gjithësesi që për disa ditë të merrja gjak dhe piastrina (pllakëza). Tani e ndiej veten mirë dhe më në fund arrij të shoh me optimizëm jetën dhe të ardhmen.

Për çfarë shërbejnë piastrinat (pllakëzat)?

Kur sëmundja (leuçemia, aplasia e palcës së kurrizit) ose terapi shumë të rënda si kemioterapia, radioterapia nuk lejojnë prodhimin e qelizave të gjakut nga ana e palcës së kurrizit, i sëmunduri ndodhet në një gjendje klinike të quajtur aplasia.

Transfuzioni me piastrina bëhet i domosdoshëm për të evituar rrezikun e hemorragjive që mund të komprometojnë jetën e të sëmurit.

Cilat janë nevojat?

Nevoja për piastrina rritet me zhvillimin e teknikave mjekësore. Jetëgjatësia e kufizuar e piastrinave, bën të domosdoshëm rregullsinë e dhurimeve për të përmbushur nevojat.

Ju duhet të dini

Dhurimi i piastrinave mund të bëhet në aferezë, në këtë rast fiksohet një takim për dhurimin.

Kush mund të dhurojë piastrina në aferezë?

Ky lloj dhurimi iu propozohet zakonisht dhuruesve të zakonshëm.

Ju duhet të dini...



Kohëzgjatja: Dhurimi zgjat 90 minuta, nga mbërritja deri në daljen tuaj parashikoni rreth 2 orë.



Intervali i dhurimit: Është i nevojshëm një interval të paktën 30 ditë nga një dhurim pllakëzash në tjetrin. Gjithësesi brenda një viti nuk mund të kryhen më shumë se 6 dhurime.

Dhurimi i gjakut të kordonit të kërthizes

Gjaku që mund të të zgjatë jetën

Në gjakun e kordonit të kërthizës, që zakonisht hidhet pas lindjes, janë të pranishme qeliza staminale, dmth në gjendje të prodhojnë qeliza gjaku, të cilat të transplantuara, ndihmojnë kurimin e personave në moshë të ndryshme që vuajnë nga sëmundje të gjakut si leucemia, limfoma ose talasemia.


Siguria

Mbledhja e gjakut bëhet pas prerjes së kordonit të kërthizës prandaj nuk përbën asnjë rrezik as për nënën dhe as për të porsalindurin. Njësitë e gjakut të dhuruar ruhen në Bankat e kordonit të kërthizës, sipas kriteresh të miratuara nga komuniteti shkencor ndërkombëtar. Të dhënat relative shkruhen në një regjistër ndërkombëtar të lidhur me qendrat e Transplantimit kompetente.

Kush mund të dhurojë?

Të gjitha gratë që konsiderohen të përshtatshme, pas një interviste paraprake. Për të dhuruar gjakun e kordonit të kërthizës ju duhet të jeni në gjendje të mirë shëndetësore në mënyrë që të minimizohet rreziku i sëmundjeve që mund t' transmetohen pacientit/marrës.

Ashtu si për dhurimin e gjakut egzistojnë disa kushte klinike dhe sjellje të rrezikshme që mund të kompromentojnë dhurimin. Gruaja duhet të kryejë një marrje gjaku periferike (për qëllim kontrolli) të përsërisë analizat për të përjashtuar mundësinë e pranisë së sëmundjeve infektive.



Manila 38 vjeç

Vuante nga leucemia mieloide akute e kurohej në Qendrën e Transplantimit në Firenze. Tregon: Singerisht isha e dëshpëruar, edhe pse duke qenë femijë i vetëm, nuk egzistonte mundësia e një dhuruesi në familje ose pranë regjistrave ndërkombëtarë të dhuruesve: për fatin tim të mirë arritën të gjejnë 2 kordona kërthize të vegjël në SHBA, të cilët më shpëtuan jetën.

Ju duhet të dini...



Allogenica: Për çdo person që mund të ketë nevojë dhe përbën dhurimin e mirëfilltë.



Dedicata: Dhurimi bëhet për një njeri me të cilin jeni fis (keni lidhje gjaku), në rast rreziku për një seri sëmundjesh.



Autologa: Ka të bëjë me mbledhjen e gjakut të kordonit të kërthizës për vetë. Kjo lloj ruajtje mund të realizohet vetëm në struktura jashtë Italisë, sepse në Itali është i ndaluar krijimi i Bankave private të gjakut të kordonit të kërthizës. Ky qëndrim është i bazuar në faktin se nuk ka prova shkencore të dobisë së qelizave staminale të gjakut të kordonit të kërthizës, për rindërtimin e organeve të dëmtuara. Nuk ka prova shkencore që gjaku i kordonit të kërthizës i konservuar për përdorim autolog nuk përmban të njëjtat qeliza malinje që kanë shkaktuar sëmundjen.



Ku mund të dhuroni? Pranë qendrave të lindjes (materniteteve) të Rajonit, të autorizuara të kryejnë marrjen e gjakut të kordonit të kërthizës: www.satute.toscana.it



800 261580

www.avis.it/toscana

Via Borgognissanti, 16 - 50123 Firenze

Tel. 055 23.98.624 - Fax 055 29.41.62 - e-mail: toscana@avis.it



055 343411

www.anpastoscana.it

Via Pio Fedi, 46/48 - 50142 Firenze

Tel. 055-787651 Fax 055-78765207 - e-mail: anpastoscana@anpastoscana.it



800 166 666

www.toscana.cri.it

Sede di Firenze: Via dei Massoni, 21 - 50139 Firenze

Tel. 055 40571 - Fax 055 400699



055 4223746

www.fratres.org

Via Ragazzi del '99, 65 - 50141 Firenze

Tel. e Fax 055 4223746 - e-mail: info@fratres.org

**Për informacione se si dhe ku mund të dhuroni
gjakun e kordonit të kërbthizës:**



0574 540002

www.adisco.it

Via del Lazeretto 168/15 - 59100 Prato

Cell. 335 1341929 / 335-5925648 - e-mail: segreteria-toscana@adisco.it

*Le traduzioni di questa pubblicazione sono state realizzate
grazie all'idea ed al contributo della delegazione Cesvot di Prato.*



Delegazione Cesvot di Prato - Via Cambioni, 35 59100 Prato

Tel. 0574 442015 - Fax 0574 443861

e-mail: del.prato@cesvot.it - www.cesvot.it



Centro Regionale Sangue Toscana - Via Taddeo Alderotti, 26/N - 50139 Firenze

crs@regione.toscana.it - www.regione.toscana.it/donareilsangue

Tel. 055 4383383 - Fax 055 4383344